

Teknomedia Sh.p.k

Selia: Rr: " Hiqmet Delvina, ndërtesa 2/4 Kodi Postar 1022"
Tirana – Albania

Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2018

(jo të audituara)

Tirane, 23 Mars 2019

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUMET

Përmbajtja

1. Bilanci Kontabël
2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
3. Pasqyra e flukseve monetare
4. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
5. Shënime

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Bilanci Kontabël

	Shen	31.12.2018	31.12.2017
<u>AKTIVET</u>			
I	Aktivët Afatshkurtëra		
1	Aktive monetare	4 3,615,305	3,808,782
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5 21,465,842	21,928,420
(ii)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	6 6,782,190	6,782,190
	Totali 3	28,248,032	28,710,610
4	Inventari		
	Totali 4	0	0
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	0	0
	Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)	31,863,337	32,519,392
II	Aktivët afatgjata		
2	Aktive afatgjata materiale		
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	7 2,354,307	2,913,677
	Totali 2	2,354,307	2,913,677
	Totali i aktiveve Afatgjata (II)	2,354,307	2,913,677
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)	34,217,644	35,433,069
<u>DETYRIMET DHE KAPITALI</u>			
I	DETYRIMET Afatshkurtëra		
2	Huamarrjet		
3	Huat dhe parapagimet		
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	8 19,457,100	19,316,303
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve	9 7,187,558	6,289,106
(iii)	Detyrime tatimore	10 3,473,442	3,170,095
	Totali i detyr. afatshkurtra (I)	30,118,099	28,775,504
II	DETYRIME AFATGJATA		
	Totali i detyrimeve	30,118,099	28,775,504
III	Kapitali		
3	Kapitali aksionar	11 100,000	100,000
	Rezerva statusore	134,000	134,000
	Rezerva të tjera	5,615,729	5,615,729
7	Fitimet e pashpërndara	807,838	1,360,762
8	Fitimi (humbja) e vitit financiar	-2,558,022	-552,925
	Totali i kapitalit (III)	4,099,545	6,657,565
	TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT	34,217,644	35,433,069

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-18

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DIJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

Pasqyra e të Ardhurave
Për periudhën që përfundon më 31.12.2018

		Viti 2018	Viti 2017
1	Shitjet neto	12	-
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	-	1,151,407
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimin në proces	-	-
4	Materiallet e konsumuara	-	-
5	Kosto e punës	13	-
	-Pagat e personelit	13	-1,029,817
	-Të tjera personeli	-	-
	-Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	13	-171,982
6	Amortizimi dhe zhvleresimet	7	-582,767
7	Shpenzime të tjera	14	-519,987
8	Totali i shpenzimeve	-2,304,553	-1,740,727
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore	-2,304,553	-589,320
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare:		-
12.2	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	15	-
12.3	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	16	-253,469
12.4	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	-	36,395
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare	-253,469	-552,925
14	<i>Fitimi (humbja) para tatimit</i>	17	-2,558,022
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	17	-
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	-2,558,022	-552,925
Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse			
	Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM	-	-
	Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinanciare	-	-
	Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet	-	-
	Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën	-2,558,022	-552,925

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-18

Pasqyrat Financiare "Teknomedia Shpk janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë
Më datë 23 Mars 2019

Administrator

Naim Jashari

TEKNOMEDIA L
PRESIDENTI

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

**Pasqyra e Flukseve Monetare 2018
(Metoda Indirekte)**

	Shen	2018	2017
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	17	-2,558,022	-552,925
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime për interesa të njohura në PASH	15		
Amortizimi i Aktive Afatgjata	9	582,767	728,460
		<u>-1,975,255</u>	<u>175,535</u>
Rritje/rënie në tepriçën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	462,578	-936,654
Rritje/rënie në tepriçën e Llogarive të Pagueshme (Furnitoreve)	8	140,796	-279,488
Rritje/Rënie në detyrimet ndaj punonjësve	9	898,452	745,480
Rritje/rënie në tepriçën e Detyrimeve tatimore	10	303,347	258,140
		<u>1,805,173</u>	<u>-212,521</u>
<u>MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u>			
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Pagesa për Blerja e aktiveve afatgjata	7	-23,397	-
		<u>-23,397</u>	<u>-</u>
<u>MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese</u>			
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Emetimi i kapitalit aksionar	11	-	-
Rritej/ pakesim Detyrimet/Te drejta -Ortakët		-	-
		<u>=</u>	<u>=</u>
<u>MM neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>			
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		<u>-193,477</u>	<u>-36,985</u>
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		<u>3,808,782</u>	<u>3,845,767</u>
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		<u>3,615,305</u>	<u>3,808,782</u>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-18

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PËRNDRYSHË SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit në kapital

	Kapitali aksionar	Fitimi i Pashpërndarë	Rezerva te tjera	Rezerva statutore	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	100,000	1,360,762	5,615,729	134,000	7,210,483
Emetim i kapitalit aksionar					
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël		(552,925)			(552,925)
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	100,000	807,836	5,615,729	134,000	6,657,557
Emetim i kapitalit aksionar					
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël		(2,558,022)			(2,558,022)
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	100,000	(1,750,186)	5,615,729	134,000	4,099,535

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-18

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Teknomedia Sh.p.k., në vijim e quajtur “Shoqëria”, është njohur si person juridik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr.16305 date 14.11.1996, me formë juridike sh.p.k. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit “Per Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, statutit të saj dhe legjisllacionit shqiptar në fuqi. Selia qendrore është në Shqipëri.

Ajo është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali është ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale 1,000 lek. Gjatë vitit 2018 nuk ka patur ndryshime në strukturën e kapitalit të saj e cila në datën 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Ortaku	% Kuotave	Numri i pjesëve	Vlera e kapitalit në ALL
Juvent Jashari	30	30	30,000
Dritan Jashari	30	30	30,000
Naim Jashari	30	30	30,000
Ilir Butka	10	10	10,000
Totali	100	100	100,000

Administratori ligjor i shoqërisë është z. Naim Jashari. Adresa e Shoqërisë është Rruga Hiqmet Delvina, ndërtesa 2/4 Kodi Postar 1022, Tiranë-Albania.

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT J62318003E

Më 31 Dhjetor 2018 shoqëria ka 2 punonjës (31 Dhjetor 2017, 2 punonjës)

Gjatë vitit 2018 shoqëria kryen aktivitetin e saj në përputhje me objektin kryesor të saj që është prodhim, transmetim dhe ritransmetim të programeve dhe informacioneve të cdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për publikun nëpërmjet valeve elektromagnetike, kabllave, perseritesave, sateliteve apo me cdo mjet tjetër. Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj veprimtarinë e Transmetimit të Programeve dhe Informacioneve Televizive etj. Për të kryer këto aktivitetet Shoqëria ka një license prej Keshilit Kombëtar të Radio Televizionit, Nr 023TVL dt 23.10.2000.

2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjisllacionin kontabël në Shqipëri dhe konkretisht sipas SKK të përmirësuar.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 Për shpalljen e detyrueshme të tyre.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHIKRUHET

2. Parimet e përgatitjes se pasqyrave financiare - vazhdim

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK-ve të përmirësuara dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabël kryesore

Një përmbledhje te pjesës me te madhe te politikave kontabël mbi bazën e te cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa me poshtë:

3.1 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM ne dore dhe ato te mbajtura ne banka.

Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare përfshin MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.2. Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj ose kur njësia ekonomike lëshon faturën për shërbimin e kryer. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer.

Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlerë të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është e evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të

Teknomedia Sh.p.k.

PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHIKRUHET

3.2. *Aktivet financiare - vazhdim*

cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme. Shoqëria nuk ka njohur për periudhën raportuese zhvlerësim të aktiveve financiare.

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SKK 3 "Instrumentet financiare: Shënime shpjeguese dhe Paraqitja" çregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

3.2 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) *Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lek (ALL), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "të tjera të ardhura (shpenzime) financiare".

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2018 janë:

Monedha	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Euro	123.42 ALL	132.95 ALL
USD	107.82 ALL	111.10 ALL
GBP	137.42 ALL	149.95 ALL

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikoohen me

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

3.4 Inventarët - vazhdim

besueshmëri. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes. Shoqëria nuk ka gjendje të materialeve dhe inventarëve të tjerë në fund të vitit 2018.

3.5 Aktivët e Afatgjata Materiale (AAM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka) Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve.

Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. AAM paraqiten në bilanc me vlerën neto nga amortizimi

(ii) Amortizimi

Amortizimi aktiveve të shoqërisë për pajisjet kompjuterike dhe për aktivet e tjera llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit.

Shoqëria ka në pronësi të saj mjete transporti, mobilje, pajisje pune dhe instalime të veçanata teknike.

Normat e amortizimit janë të paraqitura si më poshtë:

	<i>Norma Amortizimit %</i>	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Ndërtesa dhe instalime teknike	5	Me Vleftën e mbetur
Mobilje & Orendi	20	Me Vleftën e mbetur
Pajisje Informatike	20	Me Vleftën e mbetur
Makineri dhe pajisje	20	Me Vleftën e mbetur
Mjete Transporti	20	Me Vleftën e mbetur

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikën e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe të detyrime të tjera.

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

3.7 Detyrimet - vazhdim

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria nuk ka gjendje hua afatgjata në fund të periudhës raportuese.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimet e pronësisë së shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

3.9 Shpenzime për personelin

(i) Kontributet për sigurime shoqërore dhe te ngjashme

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave me ndodhjen e tyre.

3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të behet një vlerësim relativisht i sakte i shumës së detyrimit. Shoqëria nuk ka njohur provizione për vitin 2018.

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual dhe te shtyrë. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korrigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Gjatë vitit 2018 nuk kanë rezultuar diferenca të përkohëshme dhe shoqëria nuk ka njohur dhe pasqyruar tatime të shtyra mbi fitimin

Menaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Një paraqitje përmbledhur e tyre jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Mjete monetare në banke	2,859,377	3,013,204
Mjete monetare në arkë	755,928	795,578
Total	3,615,305	3,808,782

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2018 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat.

5. Llogari Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve për shërbime të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2018. Shoqëria nuk ka llogaritur ulje vlerë nga zhvlerësimi i klientëve.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit paraqitet si vijon:

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Pershkrimi i Llogarive		
Kliente për shërbime, mallra dhe produkte	21,465,842	21,928,420
Total	21,465,842	21,928,420

6. Kërkesa të arkëtueshme të tjera

Përbërja e këtij zëri të bilancit kontabël paraqitet si vijon:

Pershkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Paradhenie për shtetin - Te tjera	6,782,190	6,782,190
Total	6,782,190	6,782,190

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DIHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

7. Aktivet Afatgjata

Gjendja, shtesat dhe pakësimet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2018 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e ndryshimit të AAM	Toka, Ndertime	Pajisje dhe Instrumenta Pune	Mjete Transporti	Mobilje dhe paisje Zyre	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2017	-	21,084,082	1,962,512	6,796,412	29,843,006
Blerjet gjatë viti ushtrimor	-	23,397	-	-	23,397
Shitjet gjatë viti ushtrimor	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	-	-
Plusvlere/minusvlere rivlerësimi	-	-	-	-	-
Pakësime/Shtesa të tjera	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2018	-	21,107,479	1,962,512	6,796,412	29,866,403

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka, Ndertime	Pajisje dhe Instrumenta Pune	Mjete Transporti	Mobilje dhe paisje Zyre	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2017	-	19,255,798	1,579,078	6,094,452	26,929,328
Amortizimi i periudhes ushtrimore	-	365,657	76,719	140,392	582,768
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM te shitura	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2018	-	19,621,455	1,655,798	6,234,844	27,512,096
Vlera neto me 31 Dhjetor 2017	-	1,828,285	383,434	701,959	2,913,678
Vlera neto me 31 Dhjetor 2018	-	1,486,025	306,714	561,567	2,354,306

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 8438 date 28.12.1998, "Për Tatimin mbi te ardhurat". Këto norma marrin parasysh përafërsisht edhe jetëgjatësinë e përdorimit të këtyre aktiveve nga shoqëria.

8. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2018 për shërbimet e bëra prej tyre.

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Furnitore brenda vendit	19,457,099	19,316,303
Total	19,457,099	19,316,303

9. Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet ndaj punonjësve për pagat.

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

10. Detyrime tatimore

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet si vijon:

Detyrimet tatimore

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Shteti Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore	2,743,188	2,455,865
Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale	647,378	631,354
Detyrimet e tatim fitimit	82,876	82,876
Total	3,473,442	3,170,095

11. Kapitalet e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2018, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Kapitali i paguar	100,000	100,000
Rezerva statutore	134,000	134,000
Rezerva të tjera	5,615,729	5,615,729
Fitimi (Humbja) i/e vitit të kaluar	807,839	1,360,762
Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar	(2,558,022)	(552,925)
Total	4,099,546	6,657,565

12. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

12.1 Shitjet neto

Në këtë zë paraqiten vetëm të ardhurat nga shitjet e shërbimeve dhe punimeve të ofruara nga shoqëria:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Te ardhura nga shitja	-	1,151,407
Total	-	1,151,407

13. Shpenzime personeli

Ne shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2018. Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore paraqiten shuma e kontributeve që paguhen nga shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifatat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetësore.

Gjate vitit shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit. Paraqitja si vijon:

10

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DIHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUJHET

13. Shpenzime personeli - vazhdim

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Shpenzime per paga	1,029,817	860,000
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore e shendetsore	171,982	143,620
Total	1,201,799	1,003,620

14. Shpenzimet e tjera

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Sherbime nga te tretet	511,795	
Shpenzime telefoni, internet, dhe te ngjashme	8,190	8,647
Te tjera	-	-
Shpenzime te tjera te panjohura		
Total	519,985	8,647

15. Të ardhurat dhe shpenzime për interesa

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Te Ardhura nga Interesi	-	-
Shpenzime nga Interesi	-	-
Total	-	-

16. Fitimet dhe humbjet nga kursi i kembimit

Paraqesin shumën e të ardhurave nga këmbimet gjatë vitit në monedhë të huaj si dhe nga përkthimi në fund të vitit i gjendjeve të mjeteve monetare dhe të drejtave dhe detyrimeve në monedhë të huaj. Dinamika e këtyre rezultateve nga ndryshimeve në kurset e këmbimit paraqitet si vijon:

Fitimet dhe humbjet nga kursi i kembimit

Pershkrimi	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<i>Fitimi nga Kurset e kembimit</i>		
Fitime nga azhormimi i Arkes/Bankes	363,699	293,603
<i>Humbje nga Kurset e kembimit</i>		
Humbje nga azhormimi i Arkes/Bankes	-617,168	-257,209
Total	-253,469	36,395

17. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një humbje neto kontabël 2,558 mijë lek. Për llogaritjen e rezultatit tatimor te vitit 2018 shoqëria ka bere rregullimet e nevojshme fiskale dhe nuk ka patur shpenzime te panjohura. Humbja fiskale e shoqërisë për vitin 2018, pas rregullimeve për qëllime tatimore, rezulton ne vleren e 2,558 mijë lek.

Llogaritja e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2018 paraqiten si në tabelën vijuese:

hp

Teknomedia Sh.p.k.
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2018 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

17. Tatimi aktual - vazhdim

Pasqyra e rezultatit tatimor	Viti 2018	Viti 2017
Fitimi/Humbja e vitit	-2,558,022	-552,925
Korigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:	<u>-</u>	<u>-</u>
Shpenzime me dok jo të rregullta	-	-
<i>Shpenzime të tjera të panjohura</i>	0	
Totali i shpenzimeve të panjohura	<u>-</u>	<u>-</u>
Fitimi/Humbja i tatueshem para mbartjes së humbjes fiskale	<u>(2,558,022)</u>	<u>(552,925)</u>
Humbja fiskale nga viti		-319,748
Humbja fiskale nga viti		
Fitimi/Humbja fiskale e vitit 2018	<u>-2,558,022</u>	<u>-872,674</u>
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	<u>15%</u>	<u>15%</u>
Tatimi aktual mbi fitimin 2018	<u>-</u>	<u>-</u>
Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin	<u>-</u>	<u>-</u>

18. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.